



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 10.09.2018, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Eduard Shalsi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe KfW Frankfurt am Main për programin e rehabilitimit të konvikteve të Universitetit të Tiranës sipas parimit të eficiencës së energjisë, faza II”. *(Komision për dhënie mendimi)*

Marrin pjesë:

Eduard Shalsi, Besnik Baraj, Ilir Beqaj, Rrahman Rraja, Egllantina Gjermani, Andrea Marto, Rakip Suli, Tatjana Nurçe, Ilir Ndraxhi, Robert Bitri, Dritan Bici dhe Vullnet Sinaj.

Mungojnë:

Florjon Mima, Endri Hasa, Lorenc Luka, Izmira Ulqinaku, Hekuran Hoxhalli, Gjetan Gjetani, Agron Çela dhe Lefter Koka.

Të ftuar:

Dorina Çinari – Zëvendësministre e Infrastrukturës dhe Energjisë

Agim Bregasi - Drejtor i Energjetikës dhe Eficiencës së Energjisë në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Ardian Islami - Përgjegjesi i Sektorit në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Anisa Pina – Specialiste e medias në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Brikena Jazxhi – Specialiste në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

HAPET MBLEDHJA

Eduard Shalsi – Përsëritje, kolegë deputetë!

Duke shprehur që pas pushimeve keni marrë energjitë e nevojshme për t'iu rikthyer punës, dua t'ju bëj me dije se ju kemi vënë në dispozicion një listë të projektligjeve të ardhura në parlament dhe një draftprogram. Gjithashtu, dua t'ju bëj me dije se gjatë muajit shtator kemi planifikuar disa aktivitete. Ndërkohë, rreth 900 agjencive shtetërore u kemi dërguar një kërkesën për të na informuar për punën e tyre 1-vjeçare, duke ushtruar në këtë mënyrë edhe rolin e monitoruesit të parlamentit. Një presë prej tyre na kanë dërguar përgjigje, ndërsa pjesa tjetër ende jo.

Dua t'u rikujtoj punonjësve të komisionit që ta përsërisin edhe një herë kërkesën dhe t'ua dërgojnë përsëri agjencive për të na vënë në dispozicion informacionin lidhur me punën e tyre. Gjithashtu, kemi parashikuar edhe disa vizita në agjenci të ndryshme shtetërore.

Ndërkohë, ju bëj me dije se sot na ka ardhur një përgjigje nga kompania TAP lidhur me vizitën që do të organizojmë atje. Në parim kemi piketuar datat 21 dhe 22 për të parë pjesën kulminante të punës së këtij segmenti të rëndësishëm, që ndodhet midis Korçës dhe Skraparit. Ne po bëjmë gati datën dhe programin, të cilin do t'ju vendosim në dispozicion. Ndoshta do të na duhet që të qëndrojmë një natë atje, mund të shkojmë nga Skrapari ose nga Korça, sepse është pika më e lartë e punimeve dhe më e vështirë, me përfundimin e të cilës kompletohet edhe segmenti. Pra, do të nisemi në datën 21 shtator, që i bie ditë e premte, dhe do të kthehemi në datën 22.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Atëherë, nëse do të kemi ndonjë kërkesë tjetër, përveç këtyre që ju bëra me dije, në lidhje me veprimtarinë e komisionit, jeni të lutur që t'ua bëni me dije edhe punonjësve të komisionit, në mënyrë që t'i parashikojmë në axhendën e muajit shtator.

Në axhendën e ditës së sotme kemi shqyrtimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe KfW Frankfurt am Main për programin e rehabilitimit të konvikteve të Universitetit të Tiranës sipas parimit të eficiencës së energjisë, faza II”. Relator i këtij projektligji është zoti Suli.

Të ftuar nga Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës kemi zëvendësministren, zonjën Çinari, zotin Bregasi, zotin Islami dhe zonjën Pine. Të ftuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë kemi zonjën Jazxhi.

Mirë se keni ardhur!

Së pari, fjala është për relatorin dhe më pas për përfaqësuesit e ministrisë. Gjithashtu, do të vijojmë me pyetjet, përgjigjet dhe me diskutimet.

A jeni dakord me rendin e ditës? Në rregull!

Fjala për ju, zoti Suli.

Rakip Suli – Faleminderit, zoti kryetar!

Siç u shprehët edhe ju, sot për diskutim kemi projektligjin për marrëveshjen ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe KfW Frankfurt am Main për rehabilitimin e konvikteve të Universitetit të Tiranës. Ratifikimi i kësaj marrëveshjeje synon financimin me një fond grant prej 2 milionë eurosh.

Lidhja e kësaj marrëveshjeje propozohet në vijim të marrëveshjes qeveritare të nënshkruar ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë. Sigurimi i këtij financimi me grant në vlerën prej 2 milionë eurosh synon zbatimin e masave të eficiencës së energjisë elektrike dhe rehabilitimin e godinave të konvikteve të Universitetit të Tiranës, ku parashikohet rehabilitimi i 5 godinave.

Ky financim me grant do t'i bashkohet një financimi tjetër prej 4,5 milionë eurosh, ku marrëveshja përkatëse është ratifikuar në vitin 2016. Në varësi të buxhetit në dispozicion, projekti do të përfshijë rehabilitimin e konvikteve nr. 3, 14, 16, 17 dhe 18. Në këto godina do të kemi konsum të energjisë elektrike dhe përmirësimin e kushteve të jetesës së studentëve.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë është ministria përgjegjëse për zbatimin e këtij projekti. Ky projekt parashikohet të fillojë brenda vitit 2018 dhe do të zgjasë nga 18 deri në 24 muaj.

Meqenëse pak më lart përmenda shifrën 4,5 milionë euro, më lejoni të them se kostoja e gjithë këtij investimi shkon rreth 7,8 milionë euro, ku 2 milionë euro është marrëveshja aktuale që ne po diskutojmë konkretisht, 4,5 milionë euro është vlera e ratifikuar në vitin 2016 dhe 1,3 milionë euro është TVSH-ja, e cila do të merret përsipër nga qeveria shqiptare.

Gjithsesi, nga përfaqësuesit e ministrisë, por edhe nga pyetjet që mund të bëjnë kolegët deputetë, do të kemi sqarime më të detajuara. Faleminderit!

Eduard Shalsi – Faleminderit, zoti Suli!

Atëherë, edhe një herë një rezymë të projektit.

Këtu thuhet faza II, ndaj ku konsiston i gjithë projekti? Cilët janë komponentët e këtij projekti? Për çfarë bëhet fjalë në këtë shtesë?

Dorina Çinari – Faleminderit!

Zoti deputet e relatoi shumë saktë, por saktësisht bëhet fjalë për shumën 2,032,179 euro. Pra, nuk bëhet fjalë vetëm për shumën 2 milionë euro, por ka disa saktësime. Siç u shpreh edhe zoti deputet, i gjithë financimi është në shumën 7,8 milionë euro. Ne kemi marrë dy pjesë të financimit, ku një pjesë është në shumën 4,5 milionë euro në raundin e parë nga qeveria gjermane, të cilit i bashkëngjitet ky financim për të cilin po kërkojmë të miratohet tani.

I gjithë financimi do të përdoret për të bërë rikonstruksionin e disa godinave të Qytetit Studenti, sipas parimit të eficiencës së energjisë. Përveç përmirësimeve që do të bëhen në kuadër të ruajtjes së energjisë, do të bëhen edhe disa rikonstruksione në disa godina të tjera, që kanë lidhje me kushtet minimale të studentëve. Pra, do të krijohen disa tipologji apartamentesh: së pari, apartamente për të banuar 6-8 studentë, që do të ndajnë një banjë, një aneks kuzhine dhe një ambient për larje; apartamente për të banuar 4 studentë, që do të ndajnë një banjë, një aneks kuzhine dhe një ambient për larje dhe apartamente për të banuar 2 studentë, që do të ndajnë një banjë, një aneks kuzhine dhe një ambient për larje. Ndarja do të bëhet në varësi të mundësive ekonomike për të paguar secili student. Apartamentet me numrin më të madh do të jenë ato që do të akomodojnë nga 6 deri në 8 studentë. Me pak fjalë, këtu konsiston edhe financimi i këtij projekti. Përfitues i këtij projekti do të jetë ndërmarrja e Qytetit Studenti Tiranë.

Eduard Shalsi – Atëherë, bëhet fjalë për shumën 6,5 milionë euro. Cilët do të jenë komponentë kryesorë? Aktualisht, a ka një vlerësim të godinave në lidhje me eficiencën e energjisë?

Ne kemi miratuar një ligj, ku kemi caktuar monitoruesit dhe kontrolluesit. Pra, faza e parë është se cila është gjendja aktuale? A ka filluar, apo jo? A është pjesë e projektit, apo jo?

Së dyti, për ta strukturuar, ku konsistojnë këto fonde dhe për çfarë do të shpenzohen ato? A do të shpenzohen për dritaret, për ngrohjen e ujit, për izolimin, për termoizolimin apo për çfarë tjetër? Pra, unë po kërkoj një shpjegim nga pikëpamja teknike se ku konsiston ky projekt.

Sa godina ka aktualisht Qyteti Studenti? Sa do të përfshihen në këtë projekt? Sa do të jenë përfituesit? Sa studentë akomodohen atje? Në përfundim të projektit sa do të përfitojnë? Pra, po kërkoj një shpjegim të komponentëve, në mënyrë që secili nga ne ta ketë të qartë se në çfarë faze jemi dhe ku do të shkojmë pas projektit? Pra, këto 6,5 milionë euro a janë për të

bërë studime, a janë për analiza apo do të jenë për investime? Sa përqind të investimeve zë komponenti i monitorimit? A ezauron të gjithë Qytetin Studenti apo vetëm një pjesë? A është ky një projekt pilot apo është një projekt model? Pra, këto gjëra duam që të na i sqaroni lidhur me këtë projektligj. Fjala për ju.

Agim Bregasi – Quhem Agim Bregasi, Drejtor i Energjetikës dhe Eficiencës së Energjisë në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Siç e shpjegoi relatori, por edhe zëvendësministria, në terma të përgjithshëm do të rehabilitohen në kushtet e eficiencës së energjisë 5 godina nga 29 që janë gjithsej. Pra, janë rreth 1/6 ose 16..

Eduard Shalsi – Pra, gjithsej janë 25 godina?

Agim Bregasi – Gjithsej janë 29 godina dhe nga këto do të rehabilitohen 5 godina. Detyrimi ynë si ministri, i cila mbulon edhe efikasitetin e energjisë, është që të gjitha institucionet shtetërore apo publike të kthehen në kushtet e efikasitetit të energjisë, duke përdorur edhe energjitë e rinovueshme. Kjo kuptohet edhe nga kapacitetet financiare që mund të kemi ne, nga donacionet e ndryshme që mund të na japë qeveria apo strukturat të tjera apo nga institucionet financiare ndërkombëtare, siç është rasti konkret, ku qeveria gjermane ka ofruar 6,5 milionë euro të ndara në 2 faza.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Duke iu përgjigjur edhe pyetjeve të kryetarit, mund të them se punimet do të fillojnë nga termoizolimi, pra nga prishja e të gjitha suvatimeve, sepse dihet se këto ndërtesa janë bërë që në kohën kur unë kam qenë student, por edhe më parë. Pra, këto godina janë bërë para 50 vjetësh, me kushtet e atëhershme dhe mund të jetë bërë ndonjë rinovim i pjesshëm, por nga pikëpamja energjetike nuk ka pasur ndonjë ndërhyrje thelbësore me konceptet e sotme, në zbatim edhe të ligjit tonë, por edhe të kriterëve të eficiencës së energjisë.

Pra, do të bëhet termoizolimi dhe hidroizolimi i tarracave dhe montimi i paneleve diellore në tarracat e këtyre 5 godinave, në mënyrë që kërkesa për energji të jetë minimale. Dihet se përveç suvatimit, montimit të dyerve dhe dritareve, përsëri me konceptet e eficiencës së energjisë, kursehet minimalisht rreth 30% e konsumit aktual pa futur ...

Ilir Beqaj – Po panele diellore do të ketë?

Agim Bregasi – Patjetër, duke u nisur nga tarracat, ku do të bëhet hidroizolimi dhe termoizolimi, do të vendosen panelet diellore, të cilat do ta ulim maksimalisht kërkesën për energji që kërkohet nga sistemi. Brenda godinave do të bëjmë rikompozim të dhomave, sepse nuk do të ketë më dhoma tradicionale siç kanë qenë, ku qëndronin 8 studentë brenda dhe flinin në krevate marinar. Por, siç tha edhe zëvendësministria, do të kompozohen në bazë

edhe të mundësive financiare që mund të kenë studentët, të cilët do të akomodohen. Pra, mund të akomodohen 8 veta në një dhomë, por do të bashkohen disa dhoma duke krijuar hapësira, por edhe disa ambiente të përbashkëta, siç është ambienti i gatimit, banjë apo lavanteria me xhetona. Ambientet ku do të akomodohen 4 studentë apo 2 studentë do të jetë komforti maksimal në këtë projekt. Këtu futen instalimet e reja hidrosanitare, sepse duke rikompozuar të gjitha dhomat do të kemi një kompozim të ri edhe të kërkesës për ujë të ngrohtë apo të ftohtë, qoftë në banjë apo në lavanteri. Përsëri do të bëjmë instalime elektrike me të gjitha parametrat e mbrojtjes së jetës apo edhe të komoditetit. Pra, mund të themi se do të jenë në përputhje të plotë me kushtet e studentëve në vendet e tjera të botës, në mënyrë që nga kjo pikëpamje studentët tanë të jenë plotësisht të angazhuar vetëm për procesin mësimor. Pra, do të kemi një rikonstruksion të plotë të 5 godinave dhe në ecuri do të vazhdohet edhe me financimet e godinave të tjera. Për të mos pasur dallime, e njëjta gjë po mendohet edhe për Qytet Studentin nr. 2, i cili është Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, ku janë bërë edhe disa ndërhyrje.

Ndërsa për pyetjen tjetër të kryetarit, janë rreth 2000 studentë që do të përfitojnë nga ky rikonstruksion i 5 godinave.

Eduard Shalsi – Sa studentë ka gjithsej?

Agim Bregasi – Po të bëjmë me veprim aritmetik dhe t'i shumëzojmë me 6, janë rreth 12 mijë studentë.

Eduard Shalsi – Përfituesit janë 2000?

Agim Bregasi – Po, dhe janë me kushtet që thashë më lart, me ambiente të përbashkëta dhe në bazë të mundësive financiare që kanë studentët.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Këto janë probleme të shoqërisë që administron ambientet e Qytetit Studenti dhe të bashkisë, detyra jonë është deri këtu. Ky është një financim grant dhe nuk besoj se do të rëndojë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kjo nuk është detyrë e këtij projekti, sepse është jashtë kompetencave tona. Këto janë detyra që i takojnë bashkisë dhe shoqërisë që e administron Qytetin Studenti.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dhomat do të jenë me 8, me 4 dhe me 2 veta.

Eduard Shalsi – Kush e do fjalën me mikrofon?

Agim Bregasi – Kisha edhe diçka tjetër për ta mbyllur, nga pikëpamja energjetike do të bëhet një studim paraprak.

Eduard Shalsi – Pra, do të ketë një vlerësim paraprak.

Agim Bregasi – Po, kjo për të parë eficiencën, nëse do të dalë aq sa e kishim parashikuar.

Eduard Shalsi – Fjalën e ka zoti Beqaj, pastaj zoti Suli.

Ilir Beqaj – Faleminderit!

Në vitin 2017 ne kemi miratuar fondin prej 4 milionë lekësh. Nga atëherë deri më sot është bërë ndonjë gjë tjetër, përveçse është vlerësuar se duhen edhe 2 milionë më shumë?

Agim Bregasi – Në kuadër të vlerësimit të investimit, se sa do të duhej për rikonstruksionin e 3 godinave për studentët, janë ngritur strukturat drejtuese dhe menaxhuese në ministri dhe në Qytetin Studenti për të parë ku jemi. Janë bërë procedurat paraprake, termat e referencës për të hapur garën dhe të tjera. Në bazë të vlerësimit është konstatuar se ky fond ishte i pamjaftueshëm për ndërhyrjet që do të bënim, prandaj duke i shtuar fondit edhe 2 milionë investimi do të jetë më i plotë. Rikonstruksioni do të fillojë brenda vitit 2018 dhe do të mbarojë për 18 muaj.

Ilir Beqaj – Sipas relacionit, ju thoni që synoni të arrini reduktimin, me tregues performance, me 75 kw/orë për metër katror. Sa është sot?

Agim Bregasi – Një vlerësim se sa është shpenzuar mesatarisht në vit nuk është bërë ende. Ky është hapi i parë i këtij projekti.

Ilir Beqaj – Për të bërë hapin e parë dhe për ta filluar këtë punë i kishit mundësitë, sepse kishit fondin prej 4 milionë lekësh.

Agim Bregasi – Shifra 7.5 është nga vlerësimi paraprak që është bërë.

Ilir Beqaj – Nga studimi që është bërë, nuk ju ka penguar për ta bërë më të detajuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E kuptova. Këtë shifrën 7.5 e keni marrë si kriter europian?

Agim Bregasi – Po, është një kriter europian për qendrat studentore.

Ilir Beqaj – Pra, ju nuk mund të na thoni se sa do të kursejmë në muaj nga fatura e energjisë?

Agim Bregasi – Nuk mund ta themi, sepse duhet bërë vlerësimi se sa është konsumi sot, ose i 10 apo 20 vjetëve të fundit dhe pastaj do të shohim se ku do të arrijmë.

Ilir Beqaj – Në një paragraf më poshtë thoni: “Llogaritja e karbonit si rezultat i masave...”, kjo është teorike europiane apo është shqiptare konkrete?

Agim Bregasi – Po ta bëjmë konkrete, Qyteti Studenti ka pasur një kaldajë që punonte me qymyr apo me naftë, por ne u referohemi edhe normave europiane, sepse, nëse

vendosim panele diellore dhe termoizolim, do të thotë që do të harxhosh më pak karbon në atmosferë, pavarësisht se ku prodhohen, në Shqipëri apo në Kosovë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ne edhe kur ndërtojmë një hidrocentral themi se kemi kursyer kaq emetime karbon, pavarësisht se ne nuk kemi hedhur asgjë, por këtë energji do ta prodhojë me karbon.

Ardian Islami – Më lejoni të sqaroj faktin që përpara se të akordohej vlere prej 4.5 milionë eurosh nga KFW-ja, është bërë një vlerësim nga ana e saj për të parë gjendjen faktike të ndërtesave, nga ku rezultoi që 5 godina janë në gjendje të amortizuara. Aktualisht KFW-ja ka bërë një vlerësim paraprak, ndërkohë ka akorduar një fond të veçantë prej 155 mijë eurosh, i cili do t'i akordohet konsulentit të projektit, për të bërë vlerësimin e auditimit energjetik dhe masave që do të implementohen.

Ilir Beqaj – Ta bëj pyetjen ndryshe, përse nuk e keni propozuar edhe akomodimin me një student, një krevat, një kuzhinë dhe një banjë? Pra, pse zbritët nga 8, në 4 dhe në 2 studentë? E dini përse ju pyes, sepse gjithë merakun e kam tek akomodimi me 2 studentë. Si lindi nevoja për ndarjen me 2 studentë, sepse në pamje të parë kjo ndarje më duket e parakohshme për konviktet tona, për nevojat që kemi, se thamë se mbulojmë 1/5 e nevojave të studentëve me këtë projekt pilot? Studentët shqiptarë që shkojnë jashtë, në universitete shumë të mira, në kampuse rrijnë me 3 dhe me 4 veta.

Kam edhe një merak tjetër, duke qenë se oferta është shumë e kufizuar dhe ku ka ofertë të kufizuar ka mundësi për rrushfet, sepse do të kthehen përsëri historitë e kujdestarit të konviktit, i cili do të ndajë ambientet me 8 dhe me 2 studentë, këtë e kanë bërë në kohën tonë, i cili ndante katin e 5 me katin e 2 apo ditën e dushit, dhe këtë mundësi po ia japim përsëri. Prandaj po pyes pse e keni ndarë me 2 studentë?

Ardian Ismaili – Ne nuk e kemi këtë informacion, por, siç e theksoi edhe zonja zëvendësministre, dhomat që do të jenë me më shumë studentë do të jenë dhomat me 4 dhe me 6 studentë, ndërsa dhomat e vogla do të përcaktohen në bazë të strukturës së godinës. Pra, sipas strukturës do të përcaktohet ndarja e dhomave, nëse do të jenë me 2, me 4 dhe me 6 persona. Ky është një vlerësim që do ta bëjë konsulenti i projektit, i cili do të vazhdojë edhe me detajimin e projektit.

Eduard Shalsi – Duke parë strukturën e godinave, duke parë se çfarë muresh mund të shemben ose jo dhe se sa mund të ndërhysh në përshtatjen e dhomave, atëherë do të kemi edhe një variant.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk e ka informacionin. Mbajeni shënim këtë pyetje që t'i përgjigjeni. Pyetja ishte konkrete, përse 3 kategori, pra 2, 4 dhe 8 dhe nga ka ardhur kjo, cila është logjika e kësaj ndarjeje?

Dorina Çinari – Agjenti që ka përgatitur termat e referencës për llogari të KFW-së ka shpërndarë dokumentin me administratën e konvikteve dhe me Bashkinë e Tiranës...

Eduard Shalsi – Dorina, pyetja është përse?

Dorina Çinari – Sepse ato do të tarifohen, kjo është. Por nuk është informacioni që kemi ne.

Eduard Shalsi – Pra, nuk e kemi përgjigjen, këtë po them edhe unë.

Dorina Çinari – Nuk e kemi këtë shpjegim.

Eduard Shalsi – Pra, nuk e dimë përse janë këto 3 kategori, është shumë e thjeshtë. Nëse e dini, thojeni, nëse jo, nuk ka problem të mos dish diçka, por ta keni parasysh si pyetje. Fjalën e ka zoti Suli.

Rakip Suli – Nuk dua të jap një mendim përpara ministrisë, por mendoj se 3 kategoritë janë të ndarë nga çmimi që do të kenë. Pra, kategoria me 8 deri në 6 persona do të kenë çmim më të lirë, ndërsa me 4 persona do të ketë çmim më të lartë.

Eduard Shalsi – Ky është hamendësim, më mirë ta lëmë për më vonë.

Rakip Suli – Dakord, por është bërë një studim nga kërkesat e studentëve në vijimësi në këto konvikteve dhe kanë parë se ka pasur kërkesa për 2, për 4 dhe për 6 studentë. Kjo ishte e para.

E dyta, me sa kam informacion, në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, 2 godina kanë përfunduar dhe 2 janë në përfundim e sipër. Këto godina janë pjesë e këtij fondi që po diskutojmë, apo është investim tjetër?

Unë do të kisha një mendim, meqenëse kemi edhe përfaqësues të ministrive të Energjisë dhe të Ekonomisë, madje është ngritur edhe një drejtori për eficiencën për energjinë elektrike, në radhë të parë shembullin duhet ta japë vetë qeveria që çdo tender që do të bëhet, të bëhet me këto standarde që po diskutojmë sot, për rikonstruktimin e konvikteve, për eficiencën e energjisë eklektike, pastaj mund të shkojë edhe drejt privatit, por ne si qeveri duhet të japim shembullin e parë. Pa u futur në detaje, kam bindjen time se me këtë standard që po rikonstruktojmë këto godina mund të kursejmë nga 20 deri në 30 % energji. Faleminderit!

Agim Bregasi – Për pyetjen e fundit që tha zoti deputet, mund të them që Ministria e Energjisë, duke qenë përgjegjëse për energjitë rinovuese dhe eficiencën, kur ishim të ndërtesa e vjetër, ishim të parët që vendosëm panelet diellore dhe merrnim 15 deri në 16 % të energjisë

që na nevojitet nga panelet diellore. Ndërsa për godinën ku është sot Ministria e Infrastrukturës dhe e Energjisë, në buxhetin tonë kemi parashikuar që të rikonstruktohet brenda të gjithë parametrave energjetikë, duke dhënë shembullin edhe si institucion publik, por edhe si ministri përgjegjëse për këtë punë.

Ne kemi edhe disa tregues që duhet t'i realizojmë edhe kundrejt BE-së, prandaj edhe në diskutimet me të gjithë donatorët në fokusin tonë janë të gjitha godinat, si Qyteti Studenti, shkollat, spitalet dhe ndërtesat publike. Por edhe në projektbuxhetin e vitit të ardhshëm ne do të bëjmë një vlerësim paraprak për të gjitha institucionet shtetërore, për të parë se si është situata e ndërtesave tona. Pra, jo thjesht në familje, por edhe në institucione shtetërore që duhet verë dorë, është normale që kërkojnë një financim të madh, por e rëndësishme është që po hyjmë duke dhënë shembullin personal.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ardian Ismaili – Këto nuk janë pjesë e këtij fondi, por janë pjesë e një granti të dhënë më parë nga KFW-ja dhe tashmë është në implementim.

Eduard Shalsi – Nga KFW-ja janë financuar edhe ato?

Ardian Ismaili – Po, me pothuajse me të njëjtat terma. Tashmë kanë mbaruar 2 godina dhe ne jemi në proces të 2 godinave të tjera.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Struktura e godinave ndryshon, por në të njëjtat terma efience energjie.

Eduard Shalsi – Fjalën e ka zoti Baraj.

Besnik Baraj – Faleminderit!

Dua të bëj një sqarim, këtu bëhet fjalë për eficiencë të energjisë në përgjithësi, Rakip, dhe jo të energjisë elektrike në veçanti, sepse burimi mund të jetë druri, nafta, gazi e të tjerë.

Ajo që dua të pyes, sepse u ngacmova pak edhe nga zoti Beqaj, a keni informacion me këtë ndarje 2, 4 dhe 6, si janë raportet, sepse kjo ka lindur mbi bazën e asaj që tha edhe zoti Rakipi, pikërisht të komunikimit me drejtorinë e konvikteve në bazë të kërkesave.

Pyetja ime është: ju si ministri dhe veçanërisht KfW-ja, që e quaj një institucion jashtëzakonisht serioz dhe të ndjeshëm për problematikën mjedisore dhe që ka investuar në Shqipëri në këtë fushë për eficiencat e të tjera, a jeni të kënaqur? A janë ata të kënaqur? Mbaj mend se në projektet për pyjet, për shembull, janë tërhequr investimet dhe projektet për shkak të mos përgjigjes në kohë me eficiencë të investimeve të bëra nga ata. Pra, a jeni të kënaqur ju dhe donatorët?

Agim Bregasi - Pyetja është shumë interesante, na vë para përgjegjësisë ne si institucion zbatues në radhë të parë. Po ju informoj se marrëveshja që ne kemi sjellë sot për

miratim parashikon disa nga kushtëzimet për financim, kështu, nëse nga raportet periodike tremujore KfW –ja vëren që nuk janë zbatuar grafikët e punimeve, nuk janë çuar atje ku janë destinuar, nuk është bërë lëvrimi i pajisjeve sipas parametrave që ata kërkojnë do të bllokohen financimet dhe projekti mbetet. Fakti që me KfW- në ne kemi një histori shumë të mirë suksesi në të gjitha projektet që kemi pasur, ka qenë pikërisht nga detajimi i marrëveshjeve, nga kriteret që kanë dhënë, por edhe nga monitorimi. Për kohëzgjatje para disa muajsh të gjitha institucionet financiare kanë bërë auditim në ministrinë tonë, në drejtorinë e projekteve dhe kanë gjetur përputhje me konditat paraprake, me termat e lëvrimin të financimit. Kjo marrëveshje ka detaje që nuk lejojnë mosrealizimin e termave të referencës me të cilat është hapur gara dhe, nëse nënkontraktorët nuk zbatojnë kriteret teknike dhe mjedisore të projektit, financimet do të bllokohen menjëherë sapo do të vërehen devijime.

Andrea Marto- Faleminderit!

Duke qenë se është përfituar eksperiencë me projektet e llojeve të ndryshme, meqenëse jemi duke u integruar në Europë, a është menduar nga ministria që duhet të kemi standarde kombëtare për ndërtime të reja ose për rikonstruksionet e institucioneve shtetërore ose edhe në ndërtimet për banim që të ketë standarde që ndërtuesit të jenë të detyruar t'i pranojnë?

Agim Bregasi – Ky problem që ju ngrini ka qenë evident në Shqipëri për shumë arsye, por me ligjin nr. 116 të vitit 2016 janë përcaktuar kriteret e ndërtimeve duke përfshirë pikërisht eficiencën e ndërtesave, pra si duhet të jenë muret e jashtme, si duhet të jenë dritaret, si duhet të jenë dyert, çfarë ambientesh të përbashkëta duhet të ketë, dhe në fund është certifikata që lëshohet nga institucioni që e merr në dorëzim bashkia ose institucioni shtetëror. Pra, në ligj janë të përcaktuara, por vështirësia është në implementimin e marrëveshjes, sepse, siç tha edhe zoti Baraj, gjithnjë tentohet për ta anashkaluar në një mënyrë apo tjetër, por, duke pasur parasysh ligjin për ngrohjen dhe ftohjen e banesave, kemi ngritur edhe një agjenci për eficiencën e energjisë. Pra, është hera e parë që ngrihet një strukturë më vete në Shqipëri, një agjenci që do të merret me projekte të tilla, me monitorimin e projekteve jashtë interesave financiare, që mund të ketë ndërtuesi ose një institucion dhe të kontrollojnë se është brenda të gjitha parametrave që përcakton ligji. Nuk është proces i lehtë, sepse varet nga kapacitetet fizike, nga formimi, por në kuadër të ligjit për eficiencën dhe për energjitë e rinovueshme është parashikuar edhe krijimi i strukturave që do të bëjnë monitorimin që në llogaritje, si duhet të jetë një ndërtesë ekzistuese apo si do të ndërtohet një e re, për të certifikuar dhe licencuar persona inxhinierë të specializuar vetëm

për të parë eficiencën e energjisë. Kjo është, po themi teorikisht, një arritje shumë e madhe për këtë stad ku jemi ne, por natyrisht do të kërkojë kohën e vet për licencimin e audituesve, strukturat dhe bashkërendimi i punës në mes tyre dhe me pushtetin vendor, që i merr në dorëzim, si dhe ndërgjegjësimi dhe penalizimi i ndërtuesve. Pra, ne kemi kuadrin ligjor, planin e zbatimit, strukturën dhe licencimin i personave që do të merren si auditues të eficiencës së energjisë. Pra, pa arritur parametrat, nuk i jepet certifikata, siç është bërë zakoni tani që nuk lejohen ndryshime në ndërtim, sepse nuk ta merr në dorëzim bashkia, kështu që duhet të zbatosh të gjithë termat e eficiencës së energjisë, se ndryshe nuk të merret në dorëzim ndërtesa. Kjo është punë paraprake dhe natyrisht që janë bazat. Ne jemi shumë konsekuentë në zbatimin e saj, sepse ndër kushtet që kemi nga BE-ja sektorin tonë janë kryesisht efienca e energjisë dhe energjia e rinovueshme. Kështu që edhe kësaj pike ne po i qëndrojmë fort.

Eduard Shalsi - Zonja Gjermani.

Eglantina Gjermani - Faleminderit!

Doja t'ju përgëzoja, sepse ky investim, sidomos për pjesën e energjisë jo vetëm që kursen shpenzime për energjinë, por ruan dhe respekton edhe mjedisin. Pa dyshim janë modele pozitive që vende të zhvilluara i kanë provuar më parë. Edhe para miratimit të ligjit janë rikonstruktuar apartamente apo janë ndërtuar apartamente nga Enti Kombëtar i Banesave, sipas standardeve të eficiencës së energjisë dhe nga kontaktet me qytetarët kam mësuar se paguanin 40-50 % më pak energji elektrike se sa paguanin më parë, kështu që mendoj se kaq është marzhi i shpenzimit të energjisë elektrike ose i kursimeve që ne do të bëjmë duke investuar me eficiencën e energjisë. Mбай mend që ministri ka thënë këtu se keni filluar të mbështesni në bashki të ndryshme rikonstruksione spitalesh ose shkollash me parimet e eficiencës së energjisë dhe se do të mbështeten bashkitë, do të bëhet një thirrje e hapur ku bashkitë mund të aplikojnë. Nëse keni një program, a e keni hapur këtë program apo jo duke i ftuar bashkitë të aplikojnë? A i keni parashikuar në terma financiarë apo i keni parashikuar për vitin tjetër? Për mua është e rëndësishme që të nxiten bashkitë të aplikojnë me projekte konkrete, sidomos për objekte të rëndësishme të veçantë, siç janë spitalet dhe shkollat që të rikonstruktohen sipas parimeve të eficiencës së energjisë.

Agim Bregasi - Unë mund t'ju informoj se për këtë ne kemi një financim nga SEKO, rreth 4 milionë euro. Po jap një shembull që tashmë është realizuar, Bashkia e Vlorës ishte nga të parat që iu nënshtrua një rehabilitimi të plotë në pikëpamje për t'i kthyer mjediset sa më të kulturuara, por edhe të eficiencës së energjisë. Në fakt Bashkia e Vlorës ishte nxitja jonë, por edhe iniciativa e asaj bashkie dhe shembuj të tillë ka edhe me bashkitë e tjera. Nuk

jam i përgatitur të jap përgjigje të saktë se sa janë, por edhe Bashkia e Korçës është një nga ato bashki në pararojë për të fituar nga këto lloj financimesh. Natyrisht, duhet një punë më e madhe edhe nga ne si ministri për të sensibilizuar bashkitë që të marrin pjesë në projekte të tilla, sepse, siç e thashë, në Shqipëri gjithë stoku i ndërtesave për të mos folur për ato të para viteve '90 nuk kanë qenë të ndërtuara me eficiencën e energjisë, por sot jemi në një situatë tjetër dhe do të na duhet të kemi shumë më tepër programe të detajuara. E thashë në fillim se ne kemi parashikuar në buxhetin e shtetit projekte me objekte konkrete dhe kjo është detyra jonë.

Vullnet Sinaj- Së pari, do të doja të falënderoja qeverinë gjermane dhe KfW-në, për mbështetje të këtij programi të rehabilitimit të konvikteve me parimin e eficiencës së energjisë.

Së dyti, pas 6 muajve do të kemi 5-6 godina të sistemuara dhe pjesa tjetër e pa sistemuar, që janë rreth 29 të tilla. Pra, do të ndodhemi para kërkesës së studentëve për të qenë edhe godinat e tyre të rikonstruktura. A ka ndonjë program nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe Ministria e Energjetikës për ndonjë program të rehabilitimit të këtyre godinave të tjera?

Gjithashtu, do t'i propozoja kryetarit që, siç bëjmë vizita në institucione të ndryshme, t'i vizitojmë këto konvikte, punimet që bëhen, si dhe konviktet e tjera ku jetojnë studentët, sepse janë edhe 23 apo 24 godina të parehabilituara dhe studentët pastaj do të ankohen.

Eduard Shalsi – Meqenëse përgjegjësi i sektorit na njohu në lidhje me programin e “Studentit 2”, që është në përfundim e sipër, mund të bëjmë një vizitë aty, zoti Sinaj, për të parë konkretisht se ku konsiston investimi.

Mbajeni shënim ta kemi në axhendën e punëve të komisionit.

Kalojmë në votim. Kush është dakord në parim për marrëveshjen?

Miratohet.

Neni 1.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Nesër do të kalojmë në projektligjin e sigurisë së digave.

A kemi ndonjë informacion për opozitën?

Faleminderit!

Shihemi nesër në të njëjtën orë.

MBYLLET MBLEDHJA